



Marrëveshje bashkëpunimi

Oda Ekonomike e Kosovës dhe Fakulteti i Ekonomisë

Oda Ekonomike e Kosovës dhe Fakulteti i Ekonomisë nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me datë 03.12.2024, nr. i prot.01/1386. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Prishtinës dhe Odës Ekonomike të Kosovës është hartuar me qëllim të formalizimit të bashkëpunimit, për të forcuar lidhjet midis dy institucioneve dhe për të mbështetur zhvillimin e përbashkët akademik dhe profesional. Aktivitetet e përbashkëta ndërmjet Fakultetit të Ekonomisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës përfshijnë: pjesëmarrjen në panairin e punës, realizimin e praktikave profesionale për studentët, zhvillimin e kërkimeve dhe projekteve shkencore, si dhe shkëmbimin e informacionit dhe burimeve për zhvillim të ndërsjellë. Gjithashtu, përfaqësuesit e OEK do të ftohen si “Guest Speaker” në ligjërata apo aktivitete të tjera, ndërsa Fakulteti do të angazhojë studentët dhe stafin akademik në projekte të përbashkëta dhe ofrimin e ekspertizës në fusha të ndryshme ekonomike.

Linku: <https://www.oek-kcc.org/>